


LegalNews

January - February 2025
Janar - Shkurt 2025



Deloitte.

Ndryshon Ligji për Auditimin Ligjor

Në Fletoren Zyrtare Nr. 7, të datës 14.01.2025, është botuar ligji nr. 126, datë 19.12.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Qëllimi i ndryshimeve është plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues për të rritur cilësinë e raportimit financiar dhe jo-financiar.

Përkufizime dhe koncepte:

- **Qëndrueshmëria** është detyrim ligjor që duhet të respektojnë njësitë ekonomike për menaxhimin dhe raportimin e ndikimeve të aktuale dhe të potenciale të aktivitetit të tyre mbi çështjet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes, me fokus në respektimin e të drejtave sociale dhe të punës.
- **Raportimi i qëndrueshmërisë** është përgatitja e raporteve zyrtare e informacioneve jofinanciare, zbulimi i plotë dhe transparent i ndikimeve mjedisore, çështjeve sociale dhe të punësimit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe luftës kundër korrupsionit.
- **Skepticizmi profesional** nënkupton qëndrimin dyshues dhe vigjilent ndaj rrethanave që mund të tregojnë anomali materiale të mundshme për shkak të gabimit ose mashtrimit, dhe vlerësimi kritik i dokumentacionit që është duke i'u nënshtuar procesit të auditimit.

Amendments to the Law on Statutory Audit

In the Official Gazette No. 7, dated 14.01.2025, is published the law No. 126 dated 19.12.2024 "On some additions and amendments to law no.10091, date 05.03.2009 "On statutory auditing, organization of the profession of statutory auditor and certified accountant", as amended.

These changes aim to improve the existing legal framework and enhance the quality of financial and non-financial reporting.

Definitions and concepts:

- **Sustainability** is a legal obligation that economic entities shall comply with, to manage and report the current and potential impacts of their activity on environmental, social and governance issues, with a focus on respecting social and labor rights.
- **Sustainability reporting (ESG)** is the compilation of official reports of non-financial information, full and transparent disclosure of environmental impacts, social and employment issues, respect for human rights and the fight against corruption.
- **Professional skepticism** is the suspicious attitude, of being alert to circumstances that may indicate possible material anomalies due to error of fraud and the critical evaluation of the documentation that is being subjected to the audit process.

- **Auditim ligjor vullnetar** kryhet vetëm me kërkesë të ortakëve/ aksionarëve të njësisë ekonomike.
- **Ortaku kryesor i qëndrueshmërisë** është audituesi ligjor përgjegjës për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP)

- **BMP-ja** fiton cilësinë e personit juridik publik me qendër në Tiranë. Në ushtrimin e kompetencave nxjerr akte me karakter normativ rregullator - të cilat do të botohen në Fletoren Zyrtare, udhëzime, manuale dhe organizon sigurimin e cilësisë duke miratuar rregullore dhe metodologji të detajuara për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë. Veprimtaria e BMP-së, do të raportohet në Kuvend, brenda 4-mujorit të parë të vitit pasardhës.

Konflikti i interesave

- Përgjatë auditimit ligjor, audituesi ose shoqëria e auditimit ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar pavarësinë nga ndonjë konflikt ekzistues ose i mundshëm interesi. Pavarësia është e detyrueshme për periudhën që mbulohet nga pasqyrat financiare që do të auditohen edhe përgjatë kryerjes së auditimit ligjor.

- **Voluntary audit shall** be performed only at the request of partners/shareholders of the economic entity.
- **The sustainability partner** is the statutory auditor responsible for proving assurance on sustainability reporting.

Public Oversight Board (POB)

- **POB** acquires the status of public legal entity based in Tirana and its competencies are increased by issuing normative regulatory acts, which will be published in the Official Gazette. It also issues instructions, manuals in the implementation of the competencies provided for the legislation in force and will organize quality assurance by approving detailed regulations and methodology for quality assurance control procedures. The activity that will be exercised by the POB will be reported to the Assembly of the Republic of Albania, within the first 4 months of the following year.

Conflict of interest

- During the statutory audit, the auditor or audit firm shall take all reasonable steps to ensure independence from any existing or potential conflict of interest. Independence is mandatory for the period covered by the financial statements to be audited and during the performance of the statutory audit.

- Audituesi ligjor, shoqëria e auditimit, ortakut kryesor dhe cilido individ, shërbimet e të cilit janë në dispozicion të audituesit ligjor ose të shoqërisë së auditimit nuk duhet të pranojnë të kryejnë auditim ligjor në rast se ekziston kërcënimi i vetë-rishikimit, i interesit vetjak, i familjaritetit dhe i frikësimit të krijuar gjatë marrëdhënies financiare. Këto palë ndalohen të marrin pjesë apo të ushtrojnë ndikim në rezultatin e auditimit ligjor, nëse zotërojnë apo kanë interesa përfitimi material apo të angazhohen në transaksione të instrumentave financiare të lëshuara, të garantuara apo të mbështetura nga forma të tjera nga çdo njësi ekonomike e audituar. Përfshihen interesat e zotëruara në mënyrë të tërthortë nëpërmjet skemave të diversifikuara të investimit kolektiv, fondet e pensionit apo sigurimi i jetës.
- Nëse gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, njësi ekonomike e audituar blihet, bashkohet me një njësi ekonomike tjetër ose blen një njësi ekonomike tjetër, audituesi ligjor ose shoqëria audituese brenda tre muajve nga njohja e bashkimit ose blerjes duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të përfunduar çdo marrëdhënie aktuale ose interesi, që do të cenonte pavarësinë e tij.
- The statutory auditor, the audit firm, the head partner and any individual whose services are at the disposal of the statutory auditor, or the audit firm should not agree to carry out an audit if there is a threat of self-review, self-interest, familiarity and intimidation created during the financial relationship. They are also prohibited from participating in or exerting influence on the outcome of the audit if they own or have material interest or engage in transactions in financial instruments issued, guaranteed or supported in other forms by any audited economic entity. Interests held indirectly through diversified collective investment schemes, pension funds or life insurance are excluded.
- If, during the period covered by the financial statements, the audited entity is acquired, merges with another entity or acquires another entity, the statutory auditor or the audit firm must, within three months of becoming aware of the merger or acquisition, take all necessary steps to terminate any current relationship or interest that would impair their independence.

Kriteret për t'u bërë auditues

Gjatë praktikës së detyrueshme kandidati duhet që për të paktën tetë muaj të ushtrohet në dhënie e sigurisë për raportimin vjetor dhe të konsoliduar të qëndrueshmërisë

New requirement to become an auditor

During the mandatory internship the candidate must practice for at least eight months in providing assurance for the annual and consolidated sustainability reporting to guarantee

për të garantuar njohuri teorike dhe aftësinë për t'i vënë në praktikë njohuritë, sipas disiplinave e mëposhtme:

- Legjislacion dhe standardet në zbatim për përgatitjen e raportimit vjetor dhe të konsoliduar të qëndrueshmërisë;
- Analiza të qëndrueshmërisë;
- Procese të kujdesit të duhur në lidhje me qëndrueshmërinë.

Shtohet lista e subjektet ekonomike që i nënshtrohen auditimit ligjor të pasqyrave financiare

I nënshtrohen auditimit ligjor të pasqyrave financiare të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik, si më poshtë:

- Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit,
- Shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive,
- Shoqëritë administruese të fondeve të pensionit privat,
- Shoqëritë komisionere, institucionet e tregut, si: bursa, depozitari qendror i titujve, shtëpia e klerimit/kundërpala qendrore të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Auditimi ligjor është i detyrueshëm edhe për:

- Njësitë ekonomike të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për 2 (dy) vjet rradhazi, tejkalojnë të paktën dy nga treguesit:

theoretical knowledge and the ability to put knowledge into practice, according to the following disciplines:

- Legislation and standard in force for the preparation of annual and consolidated sustainability reporting;
- Sustainability analysis;
- Due diligence process regarding sustainability.

The list of economic entities subject to statutory audit of financial statements is expanded

All economic entities and groups of economic entities with public interest:

- Insurance and reinsurance companies,
- Collective investment fund management companies,
- Managing companies of private pension funds
- Brokerage companies, market institutions, such as: stock exchanges, central securities depositories, clearing houses/ central counterparties licensed by the Financial Supervisory Authority.

Additionally, subject to mandatory audit are:

- Economic entities which, at the end of the accounting period, for 2 (two) consecutive years, exceed at least two of the following indicators:

1. Totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël arrin ose kalon shumë prej 50,000,000 (*pesëdhjetë milion*) lekësh;
2. Shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike arrin ose kalon shumë prej 100,000,000 (*njëqind milion*) lekësh;
3. Ka mesatarisht të paktën 50 (*pesëdhjetë*) të punësuar.

1. Total assets of the balance sheet at the close of the accounting period reach or exceed the amount of 50,000,000 (*fifty million*) lek,
2. The amount of income from economic activity reaches or exceeds the amount of 100,000,000 (*one hundred million*) lek,
3. It has an average of at least 50 (*fifty*) employees.

Organizata profesionale e audituesve ligjorë ngarkohet me kontrollin e sigurimit të cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik, si dhe për hetimet për shkeljet e standardeve, si përgjegjësi e deleguar nga BMP-ja.

The professional organization of statutory auditors will be charged with quality assurance oversight for non-public interest entities, as well as investigations into violations of standards, as a responsibility delegated by the POB.

Udhëzim i Ministrit të Financave për Mënyrat dhe Procedurat për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Në Fletoren Zyrtare nr.16, datë 29.01.2025 është botuar Udhëzimi i Ministrit të Financave "**Udhëzimi**"), nr. 1, datë 21.1.2025 "*Për mënyrat dhe procedurat për zbatim nga subjektet e përfshira në veprimtari financiare*".

Udhëzimi është në zbatim të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*", të ndryshuar dhe përcakton mënyrat dhe procedurat që duhet të ndjekin subjektet e përfshira në veprimtari financiare, me qëllim parandalimin e

Instruction of the Minister of Finance on Methods and Procedures for Preventing Money Laundering and Terrorism Financing

The Official Gazette No. 16, dated 29/01/2025, has published the Instruction of the Minister of Finance ("**Instruction**") No. 1, dated 21.1.2025, "*On the methods and procedures for implementation by entities engaged in financial activities.*"

The Instruction is in accordance with law no. 917, dated 19.5.2008, "*On the Prevention of Money Laundering and Financing of Terrorism*", as amended, and defines the methods and procedures that entities engaged in financial activities shall implement to prevent money laundering and

pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Subjektet që i nënshtrohen këtij udhëzimi janë si më poshtë vijon:

- a. Bankat si dhe çdo subjekt tjetër që licençohet apo mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë;
- b. Subjektet financiare jobanka;
- c. Zyrat e këmbimeve valutore;
- d. Shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet;
- e. Shërbimet postare që kryejnë shërbime pagesash;
- f. Bursat dhe çdo subjekt që kryen aktivitet në tregtimin e titujve;
- g. Shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të pensione, si dhe agjentët e tyre;
- h. Personat fizik ose juridik që ofrojnë shërbime të mjeteve virtuale.

Subjektet e mësipërme tregojnë **vigjilencë të duhur** dhe **të zgjeruar** ndaj klientëve të tyre.

Vigjilenca e duhur

Subjektet marrin masa për të identifikuar dhe verifikuar në mënyrë të plotë e të saktë klientin, pronarin përfitues fundor dhe identitetin e tij. Në rastin e personave juridikë dhe organizimeve ligjore, duhet të njihen me strukturën e pronësisë dhe të kontrollit.

Më tej, duhet të mbledhin informacion mbi natyrën dhe qëllimet e transaksionit, për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme marrëdhënien e biznesit me klientin, analizuar transaksionet dhe përcaktuar profilin e rrezikut të klientit. Ky i fundit shërben për të përcaktuar nëse duhen zbatuar

terrorism financing.

Entities subject to this Instruction include:

- a. Banks and any other entity licensed or supervised by the Bank of Albania;
- b. Non-bank financial institutions;
- c. Currency exchange offices;
- d. Savings and credit associations and unions;
- e. Postal services that provide payment services;
- f. Stock exchanges and any entity conducting securities trading activities;
- g. Management companies of collective investment undertakings and pension funds, as well as their agents;
- h. Natural or legal persons offering virtual asset services.

Entities shall exercise **appropriate/standard due diligence** and **enhanced due diligence** towards their clients.

Standard Due Diligence

Entities shall take measures to fully and accurately identify and verify the client, the ultimate beneficial owner, and their identity. For legal persons and legal arrangements, entities shall understand their ownership and control structure.

Additionally, they shall collect information on the nature and purpose of transactions, continuously monitor business relationships, analyze transactions, and determine the client's risk profile. This risk profile helps assess whether standard due diligence or enhanced due diligence measures should be applied.

masat e vigjilencës së duhur apo të vigjilencës së zgjeruar.

Nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, subjekti siguron se transaksionet e kryera janë në përputhje me njohuritë që zotëron për klientin, natyrën e biznesit të tij, profilin e rrezikut, dhe për burimin e fondeve. Klientët me rrezik të lartë dhe marrëdhëniet e biznesit me persona juridik me pronësi indirekte trajtohen me vëmendje e shtuar. Tërësia e informacionit verifikohet periodikisht në varësi të kategorizimit të profilit të rrezikut të klientit.

Krahas këtyre masave, subjektet duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për zhvillimin e produkteve të reja, praktikave të biznesit, mënyrat e ofrimit dhe kanaleve të shpërndarjes, përdorimin e teknologjive të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, për të parandaluar rrezikun që lidhet me transaksionet apo marrëdhëniet e biznesit.

Verifikimi i informacionit, strukturës së pronësisë ligjore dhe pronësisë përfutuese verifikohet si vijon:

- Një herë në vit për klientët me rrezik të lartë;
- Një herë në tre vjet për klientët me rrezik të mesëm;
- Një herë në pesë vjet për klientët me rrezik të ulët.

Në rastet kur ushtrimi i masave të vigjilencës së duhur është i pamundur, subjekti nuk duhet të vendoset në marrëdhënie biznesi me klientin. Nëse kjo marrëdhënie ka nisur dhe klienti nuk dorëzon dokumentacionet e kërkuara, subjekti duhet ta përfundojë marrëdhënien. Në të dyja rastet subjekti duhet të

Through continuous monitoring, entities ensure that transactions align with the information they possess about the client, the nature of their business, risk profile, and source of funds. High-risk clients and business relationships involving legal persons with indirect ownership structures require extended scrutiny.

Additionally, to these measures, entities shall identify and assess the risk of money laundering and terrorist financing, for the development of new products, business practices, delivery methods and distribution channels, the use of new technologies and the improvement of existing ones, to prevent the risk associated with transactions or business relationships.

Collected information shall be periodically reviewed based on the client's risk classification:

- High-risk clients – reviewed annually;
- Medium-risk clients – reviewed every three years;
- Low-risk clients – reviewed every five years.

In the scenario where it is impossible to apply due diligence measures, the entity shall not enter a business relationship with the client. If this business relationship has already begun and the client fails to provide the required documentation, the entity shall terminate the relationship. In both cases, the

raportojë aktivitetin tek autoriteti përgjegjës.

Vigjilenca e zgjeruar

Vigjilenca e zgjeruar ushtrohet për marrëdhëniet e biznesit, klientët apo transaksionet me rrezik të lartë. Masat, ndër të tjera, përfshijnë testimin e profilit të klientit dhe identifikimin e informacionit me rëndësi.

Megjithatë, pavarësisht kategorisë së rrezikut, subjektet duhet të marrin masa të vigjilencës së zgjeruar për kategoritë e klientëve si më poshtë:

1. Persona të ekspozuar politikisht dhe familjarët e tyre (PEP);
2. Organizatat jofitimprurëse;
3. Organizmat ligjore;
4. Marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet me klient jorezidentë;
5. Shoqëri që kanë aksione të mbajtësit;
6. Transaksionet që kategorizohen si komplekse me vlera të larta dhe të pazakonta;
7. Klientët që banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende për të cilat kërkohet marrja e masave të posaçme, sipas përcaktimeve apo kërkesave të autoritetit përgjegjës;
8. Vendet me rrezik të lartë;
9. Përfituesit e policave të sigurimit të jetës.

Identifikimi dhe verifikimi i klientit kryhet duke shqyrtuar dokumente, të dhëna apo informacione të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura. Dokumentet që verifikojnë identitetin e klientit dhe statusin e tij ligjor duhet të jenë origjinale ose dokumente elektronike të vlefshme, sipas legjislacionit në fuqi.

entity shall report the activity to the competent authority.

Enhanced Due Diligence

Enhanced due diligence applies to high-risk business relationships, clients, or transactions. Measures include assessing the client's profile and identifying critical information.

Regardless of the risk category, enhanced due diligence shall be applied to the following client categories:

1. Politically Exposed Persons (PEPs) and their family members;
2. Non-profit organizations;
3. Legal trusts;
4. Business relationships and transactions involving non-resident clients;
5. Companies with bearer shares;
6. Complex, high-value, and unusual transactions;
7. Clients operating in or residing in high-risk countries, as determined by the competent authority;
8. High-risk jurisdictions;
9. Beneficiaries of life insurance policies.

Client identification and verification shall be conducted using documents, data, or information obtained from reliable and independent sources. Documents used for verification shall be either originals or valid electronic documents, in accordance with applicable laws.

Sistem i centralizuar i informacionit

Transaksionet dhe të dhënat e klientit regjistrohen dhe mbahen në një regjistër të brendshëm, në mënyrë që të analizohet dhe kontrollohet marrëdhënia e biznesit me klientin. Ky sistem i centralizuar i mundëson subjekteve të regjistrojnë të gjitha transaksionet, pavarësisht nga mënyra e kryerjes së tyre.

Kërkesat për Raportim

Subjektet raportojnë aktivitetet e dyshimta tek autoriteti përgjegjës, sipas raportimeve si më poshtë vijon:

1. Raportim i aktivitetit të dyshimtë nëpërmjet formularit elektronik RAD bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë, kur subjekti e di ose ka dyshime se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrim i produkteve të veprës penale apo financimit të terrorizmit, apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale.

2. Raportim i transaksionit të parasë fizike bëhet për transaksione me para fizike në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lek ose kundërvlera në monedha të tjera të huaja. Pavarësisht nëse transaksioni është i vetëm, apo janë disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën, raportimi kryhet elektronikisht me formularin e Raportit të Parasë Fizike (RTPF) brenda ditës pasardhëse të punës, nga data e kryerjes së transaksionit.

Centralized Information System

Client transactions and data shall be recorded and maintained in an internal registry, allowing analysis and control of business relationships. This centralized system enables entities to record all transactions, regardless of the method of execution.

Reporting Requirements

Entities shall report suspicious activities to the competent authority through the following mechanisms:

1. Suspicious Activity Report (SAR) – submitted immediately, but no later than 72 hours after the entity is aware of, or suspects that money laundering, terrorism financing, or criminal proceeds are involved. SAR is submitted electronically.

2. Cash Transaction Report (CTR) – submitted for cash transactions equal to or exceeding 1,000,000 ALL (or the equivalent in foreign currency). Regardless of whether the transaction is singular or structured into multiple linked transactions, the Physical Cash Transaction Report (PCTR) form shall be submitted electronically by the next business day.

Krahas raportimit për klientët, transaksionet dhe marrëdhëniet e biznesit, Subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës edhe përmbushjen e detyrimeve ligjore. Ky raportimin kryhet nëpërmjet raportit të kontrollit në distancë (RKD).

Masa parandaluese

Subjektet janë të detyruara të hartojnë rregullore dhe/ose udhëzime të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe të krijojnë një strukturë përgjegjëse për të parandaluar përdorimin e subjektit për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

Ndryshon ligji "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë"

Në Fletoren Zyrtare nr. 36, datë 20.02.2025 është botuar ligji nr. 6/2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002 "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë", i ndryshuar ("Ligji").

Ligji parashikon krijimin e mundësisë për pajisjen me letërnjoftim digjital për të gjithë shtetasit e pajisur me letërnjoftim elektronik.

Letërnjoftimi digjital

Letërnjoftimi digjital është dokument identiteti ku pasqyrohen qartë dhe shënohen me metoda digjitale të gjitha elementet identifikuese të shtetasit, njësoj si në letërnjoftimin elektronik, dhe elementet e mëposhtme:

Besides client, transaction, and business relationship reports, entities are required to report their compliance with legal obligations through the Remote Compliance Report (RKD).

Preventive Measures

Entities are required to draft internal regulations and guidelines for money laundering and terrorism financing prevention and establish a dedicated compliance structure to prevent the entity from being misused for illicit purposes.

Amendments to the law "On the electronic identity card of Albanian citizens"

In the Official Gazette no. 36, dated 20.02.2025, is published the law no. 6/2025 "On some additions and amendments to Law no. 8952, dated 10.10.2002 "On the electronic identification of Albanian citizens", as amended ("Law").

The Law provides for the creation of the possibility of being equipped with a digital identity card for all citizens equipped with an electronic identity card.

Digital identity card

A digital identity card is an identification document where all the identification elements of the citizens are clearly reflected and marked with digital methods, similar to the electronic identity card, and contain the following elements:

- a. çelësi kriptografik, që mundëson nënshkrimin digjital dhe certifikatën përkatëse;
- b. informacioni, që mundëson nënshkrimin digjital, përfshirë një çelës kriptografik, që mundëson nënshkrimin digjital dhe certifikatën përkatëse
- c. të dhëna të tjera teknike, të nevojshme për funksionimin ose përdorimin e identitetit digjital.

Pajisja me letërnjoftim të ri

Ligji gjithashtu sjell ndryshime në lidhje me rastet e pajisjes me letërnjoftimin e ri. Pajisja me letërnjoftim të ri do të bëhet kur:

- a. ndryshon njëri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në letërnjoftim;
- b. vërtetohet nga organet përkatëse se letërnjoftimi ka humbur ose është vjedhur;
- c. letërnjoftimi është dëmtuar, ose
- d. në çdo rast tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike është përgjegjëse për krijimin e letërnjoftimit digjital dhe të infrastrukturës teknike e teknologjike përkatëse.

- a. the cryptographic key, which enables the digital signature and the corresponding certificate;
- b. the information, which enables the digital signature, including a cryptographic key, which enables the digital signature and the corresponding certificate;
- c. other technical data, necessary for the functioning or use of the digital identity.

Obtaining a new identity card

The law also brings changes regarding cases of being issued with a new identity card. Issuance of a new identity card shall be made when:

- a. one of components of the civil status, reflected in the identity card, has changed;
- b. it is confirmed by the relevant authorities that the identity card has been lost or stolen;
- c. the identity card has been damaged, or
- d. in any other case stipulated by the legislation in force.

The company responsible for the production and distribution of biometric documents is responsible for the creation of the digital identity card and the relevant technical and technological infrastructure.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Ened Topi

Legal Senior Managing
Associate
Deloitte Legal sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
Mob: +355 69 23 87 494
E-mail: etopi@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the “Deloitte Network”) are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.